



Prishtinë, 1 shkurt 2016

## NJOFTIM PËR MEDIA

### Procesi i Shqyrtimit Tarifor

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), njofton publikun se aktualisht është duke zhvilluar procesin e dhjetë tarifor të energjisë elektrike.

Si pjesë e këtij procesi, operatorët: KEK (Gjenerimi), KOSTT (Transmisioni dhe Tregu), KEDS (Distribucioni) dhe KESCO (Furnizimi) kanë dorëzuar aplikacionet e tyre për aprovimin e të hyrave të lejuara maksimale dhe këto aplikacione janë të publikuara në faqen elektronike të ZRRE-së [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org).

Ekspertët e Departamentit të Tarifave dhe Çmimeve janë duke shqyrtuar këto aplikacione dhe së shpejti pritet të dilet me vlerësimin e këtyre aplikacioneve. Vlerësimi ekspertëve të ZRRE-së do të nënshtrohet diskutimeve publike ku do të përfshihen të gjitha palët e interesuara.

Vlerësimi i ekspertëve dhe komentet nga palët e interesit do të shqyrtohen përfundimisht nga Bordi i ZRRE-së i cili do të marr vendimin përfundimtar për të Hyrat Maksimale të lejuara të Operatorëve si dhe tarifatat për konsumatorët fundor.

Vendimi i Bordit për të Hyrat e Maksimale të lejuara dhe tarifave përfundimtare pritet të merret kah fundi i muajt mars. Tarifatat e reja të energjisë elektrike hynë në fuqi nga 1 prilli 2016.